

L I G J

Nr.8036, datë 22.11.1995

FZ. 25-1995

PER RATIFIKIMIN E "KONVENTES PER NDIHMEN E NDERSJELLE
GJYQESORE NE FUSHAT CIVILE, TREGTARE DHE PENALE NDERMJET
REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE REPUBLIKES SE TURQISE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e "Konventës për ndihmën e ndërsjellë gjyqësore në fushat civile, tregtare dhe penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1310, datë 30.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha

KONVENTE

MBI NDIHMEN E NDERSJELLTE GJYQESORE NE FUSHAT CIVILE, TREGETARE DHE PENALE MIDIS REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE REPUBLIKES SE TURQISE

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë, duke u nisur nga dëshira për të forcuar lidhjet miqësore midis dy vendeve dhe për të rregulluar ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore në fushat civile, tregëtare, penale, të ekstradimit dhe të transferimit të personave të dënuar, mbi bazën e parimeve të sovranitetit, të pavarësisë kombëtare, të barazisë në të drejta dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme, vendosën të arrijnë në përfundimin e një Konvente mbi ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore në fushat civile, tregëtare e penale dhe, për këtë qëllim, ranë dakord për dispozitat e mëposhtme:

PJESA E PARE

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

1. Shtetasit e njëres prej Palëve Kontraktuese gëzojnë, në territorin e Palës tjetër Kontaktuese, të njëjtin trajtim si dhe shtetasit e kësaj të fundit sa i përket mbrojtjes ligjore dhe gjyqësore të personit të tyre, të pasurive dhe të interesave të tyre.

2. Shtetasit e njerës prej Paleve Kontraktuese, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kanë të drejtë t'u drejtohen lirisht gjykatave dhe autoriteteve të tjera kompetente në fushat civile, tregëtare dhe penale dhe për ndjekjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre me të njëjtat kushte dhe me të njëjtat formalitete si dhe shtetasit e Palës tjetër.

3. Personat juridikë që kanë selinë e tyre në territorin e njerës prej Palëve Kontraktuese dhe të krijuar në përputhje me kushtet e legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese, do të mund të gëzojnë dispozitat e kësaj Konvente në masën që ato mund të zbatohen ndaj tyre.

Neni 2

Për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente, autoritetet e Palëve Kontraktuese komunikojnë midis tyre përmes kanaleve diplomatike.

Neni 3

Ministritë e Drejtësisë të Palëve Kontraktuese, me kërkesë të njerës Palë, informojnë njera tjetrën për legjislacionin në fuqi ose që ka qenë në fuqi në territoret e të dy Palëve dhe për praktikat gjyqësore lidhur me çështjet juridike që janë objekt i kësaj Konvente.

PJESA E DYTE**KREU 2****NDIHMJA E NDERJELLTE GJYQESORE NE FUSHAT
CIVILE E TREGETARE****Neni 4**

1. Autoritetet Kompetente të Palëve Kontraktuese marrin përsipër t'i japin njëra-tjetrës ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore në fushën civile dhe atë tregëtare.

2. Ndihmja e ndërsjelltë gjyqësore përfshin ekzekutimin e akteve proceduriale siç janë, në veçanti, përcjellja e dokumenteve, ekspertiza dhe dëgjimi i palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve.

Neni 5

1. Kërkesa për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore do të përmbajë:

- a) emërtimin e autoriteteve kërkuese dhe të kërkua;
- b) objektin e çështjes, për të cilën kërkohet ndihma e ndërsjelltë gjyqësore;
- c) emrat dhe mbiemrat e palëve, vendbanimin ose vendqëndrimin, shtetësinë dhe profesionin e tyre;
- d) emrat, mbiemrat dhe adresat e përfaqësuesve të palëve;
- e) objektin e kërkesës dhe të dhënat e nevojshme për ekzekutimin e saj.

2. Kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore dhe dokumentet e bashkëngjitura duhet të jenë të nënshkruara dhe të pajisura me vulë zyrtare.

Neni 6

1. Në përmbushjen e kërkesës për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore, autoriteti i kërkuar zbaton legjislacionin e Shtetit të vet. Ndërkaq, ai, me kërkesë të palës kërkuese, mund të zbatojë dispozitat procedurale të Palës tjetër Kontraktuese për aq sa këto të fundit nuk vijnë në kundërshtim me ligjet e Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Kur autoriteti i kërkuar nuk është kompetent për të përmbushur kërkesën për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore, ai ia përcjell këtë autoritetit kompetent të Palës së kërkuar dhe njofton për këtë autoritetin kërkuar.

3. Pas përmbushjes së kërkesës për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore, autoriteti i kërkuar i kthen dosjen autoritetit kërkuar ose e njofton atë për motivet e mospërmbushjes së kërkesës në fjalë.

Neni 7

1. Njoftimet e notifikuara kryhen nga autoriteti i kërkuar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë në shtetin e vet kur dokumentet për njoftim janë përpiluar në gjuhën e palës së kërkuar ose shoqërohen me përkthim të vërtetuar në gjuhën e kësaj pale. Në rast të kundërt, autoriteti i kërkuar i njofton dokumentin marrësit vetëm kur ky i fundit pranon t'a marrë atë.

2. Kërkesa për njoftim të notifikuar duhet të përmbajë adresën e saktë të marrësit dhe të caktojë dokumentin që duhet njoftuar.

3. Kur dokumentet nuk mund të njoftohen në adresën e treguar në kërkesën për njoftim, atëherë autoriteti i kërkuar duhet të marrë masat e nevojshme për të gjetur adresën e saktë të marrësit. Në qoftë se gjetja e kësaj adrese paraqitet e pamundur, atëherë autoriteti i kërkuar njofton për këtë autoritetin kërkuar dhe i kthen atij dokumentin që duhej të njoftonte.

Neni 8

Akti i marrjes në dorëzim të dokumenteve bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi në vendin e palës së kërkuar. Akti i marrjes në dorëzim duhet të tregojë datën dhe vendin e njoftimit.

Neni 9

Pala kontraktuese e kërkuar do të përballojë të gjitha shpenzimet e bëra në vendin e vet për dhënien e ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore dhe nuk do të kërkojë shlyerjen e tyre.

Neni 10

Akti i ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore mund të mos pranohet kur përmbushja e tij rrezikon të prekë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 11

1. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 7 dhe në nenin 13 të kësaj Konvente, kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore si dhe aktet që i bashkëngjiten atyre do të shoqërohen me një përkthim të vërtetuar në përputhje me gjuhën e palës së kërkuar, ose në frëngjisht, ose në anglisht.

2. Legalizimi i përkthimit mund të kryhet nga autoriteti kërkuar me anë të një përkthyesi të njohur zyrtarisht, nga një noter ose nga një përfaqësues diplomatik ose konsullor i njerës prej Palëve Kontraktuese.

3. Ekzekutimi i kërkesave për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore bëhet në gjuhën e Palës së kërkuar.

Neni 12

1. Dëshmitari ose eksperti, i cili, pavarësisht nga shtetësia e tij, paraqitet vullnetarisht në bazë të një kërke, përpara autoritetit gjyqësor të Palës tjetër Kontraktuese, nuk mund të ndiqet ose të arrestohet brenda territorit të kësaj Palë Kontraktuese për një shkelje të kryer përpara se të ketë hyrë në territorin e Palës Kontraktuese kërkuar dhe as të dënohet në bazë të një vendimi të dhënë më përpara.

Dëshmitari ose eksperti e humb këtë imunitet kur ai nuk është larguar nga vendi i Palës Kontraktuese kërkuar brenda pesëmbëdhjetë ditëve pasi autoriteti që e ka thirrur i ka bërë të ditur se prania e tij nuk është më e nevojshme. Ky afat nuk përfshin periudhën gjatë së cilës dëshmitari ose eksperti nuk ka mundur, jo për faj të tij, të largohet nga vendi i Palës Kontraktuese kërkuar.

Këta persona nuk mund as të ndiqen dhe as të arrestohen për kallzimin ose ekspertizën e tyre.

2. Autoriteti kërkuar duhet të njoftojë personin e thirrur si dëshmitar ose ekspert se shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit do t'i shlyhen; për ekspertin, zhdëmtimi do të paguhet sipas rasteve të parashikuara nga legjislacioni i Palës Kontraktuese kërkuar. Me kërkesë të këtij personi, autoriteti në fjalë i jep atij një paradhënie për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit.

KREU 3

DOKUMENTE

Neni 13

Me kërkesë të gjykatave dhe të autoriteteve të tjera kompetente të njerës prej Palëve kontraktuese, Pala tjetër i lëshon atyre, pa përkthim dhe falas, çertifikata të gjendjes civile dhe dokumente të tjera që lidhen me çështje vetjake dhe interesa të shtetasve të Palës nga vjen kërkesa.

Neni 14

1. Dokumentet si dhe dërgesat apo ekstraktet e tyre, të përpiluara, të lëshuara ose të vërtetuara në përputhje me origjinalin nga autoritetet kompetente në territorin e njerës prej Palëve Kontraktuese dhe të pajisura me vulë zyrtare, nuk kanë nevojë të legalizohen në territorin e Palës tjetër.

2. Aktet publike të përpiluara në territorin e njerës prej Palëve Kontraktuese kanë të njejtën fuqi vërtetuese të akteve publike në territorin e Palës tjetër.

KREU 4

PERJASHTIMI NGA TAKSAT OSE SHPENZIMET GJYQESORE

Neni 15

Shtetasit e njerës prej Palëve Kontraktuese nuk detyrohen të depozitojnë shumën për kushtin *judicatum solvi* për të vetmin motiv se janë të huaj dhe se nuk kanë as banesë as vendqëndrim në territorin e kësaj Pale Kontraktuese.

Neni 16

1. Shtetasit e njerës prej Palëve Kontraktuese përfitojnë para gjykatave të Palës tjetër Kontraktuese përjashtimin nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore si dhe ndihmën gjyqësore falas me të njejtat kushte dhe me të njejtën shtrirje si dhe shtetasit e kësaj Pale Kontraktuese.

2. Kjo ndihmë gjyqësore dhe ndihma falas zbatohen në të gjitha fazat dhe aktet e procesit duke përfshirë këtu edhe aktet e ekzekutimit.

3. Shtetasit, të cilët në përputhje me dispozitat ligjore të njerës prej Palëve Kontraktuese, përfitojnë përjashtimin nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore, përfitojnë gjithashtu edhe për aktet procedurale të kryera në lidhje me të njëjtën çështje në territorin e Palës tjetër.

Neni 17

1. Vërtetimi lidhur me gjendjen personale, familjare ose pasurore, i nevojshëm për të përfituar sipas dispozitave të nenit 16, duhet të lëshohet nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij.

2. Kur kërkuesi nuk banon ose nuk ka vendqëndrim në territorin e njerës apo tjetrës Palë Kontraktuese, përfaqësia diplomatike ose konsullore mund t'i lëshojë atij vërtetimin e duhur të përmendur.

3. Autoriteti gjyqësor i caktuar për të vendosur lidhur me kërkesën e përjashtimit nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore, duke ndjekur procedurën e parashikuar në nenin 2 të kësaj Konvente, mund t'i kërkojë të dhëna plotësuese autoritetit që ka lëshuar vërtetimin në fjalë.

Neni 18

Kur gjykata e njerës prej Palëve Kontraktuese cakton një afat për përmbushjen e një akti procedural të caktuar nga një person, banues ose qëndruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ky afat fillon nga data kur marrësi merr njoftimin zyrtar të dokumentit.

KREU 5

NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE NE FUSHAT CIVILE DHE TREGETARE

Neni 19

1. Çdo Palë Kontraktuese do të njohë dhe ekzekutojë në territorin e vet, në kushtet e parashikuara nga kjo Konventë, vendimet e mëposhtëme që jepen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese:

- a) vendime gjyqësore të dhëna në fushat civile dhe tregëtare me karakter pasuror;
- b) vendime gjyqësore të dhëna në fushën penale lidhur me shlyerjen e dëmeve;

- c) vendime të formës së prerë të dhëna nga arbitri në fushat civile e tregëtare.

2. Konsiderohen të tilla, vendimet gjyqësore dhe ato arbitrale të formës së prerë të dhëna në fushat civile e tregëtare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Përsa i përket germës a) të paragrafit 1, vendimet merren parasysh vetëm kur marrëdhëniet juridike që lidhen me to do të vendosen pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3. Vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me gjendjen e personave do të njihen edhe po të jenë dhënë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

Neni 20

Vendimet e përmendura në Nenin 19 njihen dhe ekzekutohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në qoftë se ato u përmbahen kushteve të mëposhtëme:

- a) vendimi ka marrë formë të prerë dhe është bërë i ekzekutueshëm në bazë të ligjeve të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ai është dhënë;
- b) autoriteti i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës është dhënë vendimi, është kompetent në fushën përkatëse, sipas ligjeve të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës kërkohet ekzekutimi;
- c) pala që ka humbur është thirrur në mënyrë të rregullt sipas ligjeve të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është dhënë vendimi;
- d) palëve nuk u është hequr mundësia për t'u mbrojtur, ato janë njoftuar zyrtarisht dhe përfaqësuar në rast të pazotësisë së tyre për të vepruar;
- e) në të njëjtën procedurë, ndërmjet të njëjtave palë dhe në territorin e Palës Kontraktuese ku vendimi duhet të ekzekutohet, nuk ka pasur një vendim të mëparshëm gjyëesor ose arbitror të formës së prerë;
- f) kur nuk ka veprim procedural të filluar më përpara pranë një organi gjyqësor të kësaj Pale Kontraktues, që përfaqësojnë të njëjtat palë, të njëjtën çështje me të njëjtin objekt;
- g) kur, sipas ligjeve të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës vendimi duhet të njihet dhe të ekzekutohet, duhej të ishin zbatuar ligjet e kësaj Pale, vendimi njihet dhe ekzekutohet vetëm kur:
 - 1. ligjet efektivisht janë zbatuar;
 - 2. këto ligje të zbatuara nga Pala tjetër Kontraktuese nuk ndryshojnë në thelb nga këto ligje;
- h) vendimi nuk është në kundërshtim me parimet themelore të rendit ligjor dhe të rendit publik të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës vendimi duhet të njihet dhe të ekzekutohet.

Neni 21

Vendimet e dhëna nga arbitri do të ekzekutohen në qoftë se, përveç kushteve të parashikuara në nenin 20 (me përjashtim të germës f)), përmbushen bashkërisht edhe kushtet e mëposhtëme:

- a) sipas dispozitave të ligjit të Palës Kontraktuese ku vendimi duhet të ekzekutohet, çështja mund të jetë objekt i një rregullimi arbitror;
- b) vendimi arbitror jepet për një mosmarrëveshje të parashikuar ose të rregulluar me dispozitat e një marrëveshjeje arbitrore ose të një klauzole kompromisi të palëve të interesuara;
- c) përbërja e organit gjykues arbitror ka qenë në përputhje me marrëveshjen palëve ose me klauzolën e kompromisit midis palëve të interesuara ose me ligjin e Shtetit ku është dhënë vendimi arbitror;
- d) palët janë vënë në dijeni siç duhet për emërimin e arbitrit ose për rregullimin nën kujdesin e arbitrit;
- e) vendimi arbitror ka marrë formë të prerë në Shtetin ku është dhënë.

Neni 22

1. Kërkesa për pranimin ose dhënien e autorizimit të ekzekutimit mund të paraqitet para autoriteteve gjyqësore kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës vendimi duhet të ekzekutohet sipas nenit 2 të kësaj Konvente.

2. Kesaj kërkesë duhet t'i bashkëngjiten:

- a) një dërgesë e vendimit ose një kopje e vërtetuar në përputhje me të si dhe një vërtetim që siguron faktin se vendimi ka marrë formë të prerë dhe ai është i ekzekutueshëm po qe se kjo nuk del qartë në vendim;
- b) një vërtetim që siguron faktin se pala, kundër së cilës është dhënë vendimi, është thirrur në mënyrë të rregullt dhe se ka qenë e mundur që kjo e fundit, në rast të pazotësisë për të vepruar, të përfaqësohet në mënyrë të vlefshme;
- c) përkthimi i vërtetuar dhe i legalizuar në përputhje me dokumentet e përmendura në germat a) dhe b) ose në gjuhën e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës vendimi duhet të ekzekutohet, ose në gjuhën frënge, ose në gjuhën angleze.

3. Kur kërkesa për ekzekutim (*exequatur*) formulohet në vijim të vendimit të një juridiksioni arbitror, ajo duhet të shoqërohet me një përkthim të vërtetuar konform me kompromisin ose me klauzolën e kompromisit të bërë në përputhje me paragrafin 2 germa c).

Neni 23

1. Ndaj procedurës që lidhet me vendimin për ekzekutim dhe me ekzekutimin e një vendimi të nxjerre nga Pala tjetër Kontraktuese, zbatohet ligji i Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ky vendim duhet të ekzekutohet.

2. Në këtë procedurë, autoriteti gjyqësor mjaftohet të verifikojë përmbushjen bashkërisht të kushteve të vëna nga kjo Konventë, pa i hyrë shqyrtimit të vendimit në themel.

Neni 24

Dispozitat e kësaj Konvente mbi ekzekutimin e vendimeve nuk çënojnë dispozitat ligjore të Palëve Kontraktuese lidhur me xhirimin e parave ose me eksportimin e objekteve të marra si rezultat i një ekzekutimi gjyqësor.

PJESA E TRETE**KREU 6****NDIHMA E NDERSJELLTE GJYQESORE NE FUSHEN PENALE****Neni 25**

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër për t'i dhënë njera-tjetrës ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale.

2. Ndihma e ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale përfshin ekzekutimin e akteve procedurale siç janë, në veçanti, përcjellja e dokumenteve, aktet e kontrollit, sekuestrimi dhe dorëzimi i provave bindëse, aktet e ekspertizës, aktet e pyetjes të të pandehurve dhe të dëshmitarëve, dëgjimi i ekspertëve si dhe konstatimet nga kqyrja e vendit të ngjarjes.

Neni 26

1. Kërkesa për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale do të përfshijë:

- a) emërtimin e autoriteteve kërkuese dhe të kërkua;
- b) objektin e çështjes;

- c) emrin, mbiemrin, vendbanesën ose vendqëndrimin e të pandehurve ose të dënuarve, shtetësinë dhe profesionin e tyre dhe, brenda mundësive, vendlindjen dhe datëlindjen e të pandehurve ose të dënuarve si dhe emrat e prindërve të tyre;
 - d) emrat, mbiemrat dhe adresat e përfaqësuesve ligjorë të tyre;
 - e) objektin e kërkesës dhe të dhënat e nevojshme për ekzekutimin e saj si dhe cilësimin dhe karakteristikat e veprës penale.
2. Kërkesat dhe dokumentet që u bashkëngjiten duhet të jenë të nënshkruara dhe të pajisura me vulën zyrtare të autoritetit që i ka lëshuar.

Neni 27

1. Për të ekzekutuar një kërkesë të ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore, autoriteti i kërkuar zbaton dispozitat e vendosura nga ligji në fuqi në Shtetin e vet. Megjithatë, autoriteti i kërkuar, me kërkesë të autoritetit kërkuar, mund të zbatojë dispozitat procedurale të Palës tjetër Kontraktuese në rast se këto nuk janë në kundërshtim me ligjet e Palës së kërkuar.

2. Në rast se autoriteti i kërkuar nuk është kompetent për të ekzekutuar kërkesën e ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore, atëherë ky ai përcjell këtë autoritetit kompetent të Palës së kërkuar dhe njofton për këtë Palën kërkuar.

3. Me kërkesë të autoritetit kërkuar, autoriteti i kërkuar e njofton këtë për datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore. Autoriteti i kërkuar mund të japë pëlqimin për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoritetit kërkuar në ekzekutimin e ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore.

4. Pasi të ketë kryer ekzekutimin e kërkesës për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore, autoriteti i kërkuar ia kthen dosjen autoritetit kërkuar ose e njofton atë për pengesat që kanë dalë në ekzekutimin e kërkesës.

Neni 28

1. Në rast se gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore para një gjykate ose një autoriteti gjyqësor të njerës prej Palëve Kontraktuese del e nevojshme paraqitja e një dëshmitari ose eksperti që banon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, atëherë gjykata ose autoriteti tjetër kompetent i kësaj Pale mund t'i drejtohet autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese për t'i dorëzuar atij thirrjen zyrtare për t'u paraqitur para saj.

2. Në rastin e parashikuar në paragrafin 1, thirrja nuk mund të shoqërohet me gjobë ose me masa të tjera shtrënguese në rast mosparaqitjeje.

3. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit si dhe pagesa e një zhdëmtimi për dëshmitarët ose ekspertët janë në ngarkim të Palës kërkuar.

4. Asnjë dëshmitar apo ekspert i çfarëdo shtetësie qoftë, i cili, pas marrjes së njoftimit zyrtar, paraqitet vullnetarisht para autoritetit kompetent të Palës tjetër

Kontraktuese, nuk mund as të ndiqet penalisht, as të burgoset dhe as të dënohet në territorin e kësaj Pale për vepra të kryera përpara se të hynte në këtë territor. Gjithashtu, personat e përmendur nuk mund të ndiqen, të burgosen ose të dënohen për deponimet ose ekspertizën e tyre për fakte që janë në lidhje me çështjen penale që është objekt i procedurës.

5. Dëshmitari ose eksperti e humbet imunitetin e parashikuar në paragrafin 4 kur ai nuk largohet nga territori i Palës kërkuese brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh duke u nisur nga data e njoftimit zyrtar të lëshuar nga autoriteti që e ka dëgjuar, me të cilin ai njoftohet se prania e tij nuk është më e nevojshme. Në këtë afat nuk përfshihet periudha kohore, gjatë së cilës dëshmitari ose eksperti, për arsye që nuk varen prej tij, nuk ka pasur mundësi të largohet nga territori i Palës kërkuese.

Neni 29

1. Njoftimet zyrtare bëhen nga autoriteti i kërkuar në përputhje me dispozitatat ligjore që rregullojnë këtë fushë në Shtetin e tij në rast se dokumentet që duhen njoftuar zyrtarisht janë përpiluar në gjuhën e Palës së kërkuar ose shoqërohen me një përkthim konform të vërtetuar në gjuhën e kësaj Pale. Në rast të kundërt, autoriteti i kërkuar ia dorëzon zyrtarisht dokumentin marrësit vetëm kur ky i fundit pranon ta marrë atë.

2. Kërkesa për njoftim zyrtar duhet të përmbajë adresën e saktë të marrësit dhe të caktojë dokumentin që duhet njoftuar zyrtarisht.

3. Kur dokumentet nuk mund të njoftohen zyrtarisht në adresën e treguar në kërkesën e njoftimit, autoriteti i kërkuar duhet të marrë masat e duhura për të përcaktuar adresën e saktë të marrësit. Në rast se përcaktimi i kësaj adrese rezulton i pamundur, atëherë autoriteti i kërkuar njofton për këtë autoritetin kërkues dhe ia kthen atij dokumentet që duheshin njoftuar.

Neni 30

Marrja në dorëzim e dokumenteve bëhet në përputhje me dispozitatat në fuqi në territorin e Palës së kërkuar. Në aktin e marrjes në dorëzim duhet të figurojnë vendi dhe data e njoftimit zyrtar.

Neni 31

Me rezervën e dispozitave të nenit 28, paragrafi 3, Pala kontraktuese e kërkuar përballon të gjitha shpenzimet e bëra në territorin e vet për ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore dhe nuk i kërkon Palës tjetër kthimin e tyre.

Neni 32

1. Ndihma e ndërsjelltë gjyqësore mund të mos jepet:

- a) kur Pala e kërkuar çmon se ekzekutimi i kërkesës është me natyrë të tillë që cënon sovranitetin, sigurimin ose rendin publik të vendit të saj;
- b) kur kërkesa është e papranueshme në bazë të legjislacionit të brendshëm të Palës së kërkuar.

2. Mospranimi për dhënie të ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore në rastet e parashikuara në paragrafet e mësipërme duhet të jetë i motivuar.

Neni 33

1. Përveç rasteve të parashikuara në nenin 29, paragrafi 1 dhe në nenin 57 të kësaj Konvente, kërkesat si dhe aktet që u bashkëngjiten atyre duhet të shoqërohen me përkthim të vërtetuar konform në gjuhën e Palës kërkuese, në frëngjisht ose në anglisht.

2. Legalizimi i përkthimit mund të bëhet nga autoriteti kërkuar ose nga një përkthyes i licencuar ose nga një noter ose nga një përfaqësues diplomatik ose nëpunës konsullor i njerës prej Palëve Kontraktuese.

3. Ekzekutimi i kërkesave bëhet në gjuhën e Palës së kërkuar.

KREU VII**EKSTRADIMI I PERSONAVE****Neni 34**

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, Palët Kontraktuese marrin përsipër, përkundrejt një kërkesë, t'i dorëzojnë njera tjetrës personat që banojnë në territorin e tyre për të ushtruar ndjekje penale ose për të zbatuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

2. Ekstradimi për të ushtruar ndjekjen penale mund të kërkohet vetëm për vepra penale, të cilat, sipas ligjit të të dy Palëve Kontraktuese, parashikohet të dënohen me masën e heqjes së lirisë me më shumë se dymbëdhjetë muaj ose me një masë më të rëndë.

3. Ekstradimi që synon ekzekutimin e një vendimi gjyqësor mund të kërkohet vetëm për vepra penale të dënueshme nga ligji i të dy Palëve Kontraktuese dhe kur personi që e ka kryer është dënuar me heqje lirie me më

shumë se gjashtë muaj ose me një dënim më të rëndë.

4. Kur kërkesa për ekstradim lidhet me disa vepra penale të dallueshme njera nga tjetra ku secila prej tyre, sipas ligjit të të dy Palëve Kontraktuese, dënohet me heqje lirie, por kur disa prej tyre nuk përmbushin kushtet e parashikuara në paragrafet 2 dhe 3, atëherë Pala e kërkuar mund të japë pëlqimin për ekstradim për këto vepra penale.

Neni 35

1. Ekstradimi nuk pranohet në rastet e mëposhtëme:

- a) kur personi, i cili kërkohet për ekstradim është shtetas i Palës së kërkuar;
- b) kur ekstradimi është i papranueshëm sipas legjislacionit të brendshëm të Palës së kërkuar ose kur vendimi i gjykatës nuk mund të ekzekutohet për shkak të parashkrimit ose të një rrethane të parashikuar nga ligji;
- c) kur personi, i cili kërkohet për t'u ekstraduar është bërë, në territorin e Palës së kërkuar, objekt i një vendimi të formës së prerë lidhur me të njëjtën vepër penale ose kur çështja është pushuar;
- d) kur vepra penale është kryer në territorin e Palës së kërkuar.

2. Në qoftë se Pala e kërkuar nuk pranon ekstradimin për shkak se personi i kërkuar për ekstradim është shtetas i saj, atëherë, me kërkesën zyrtare të Palës kërkuese, ajo duhet të fillojë ushtrimin e ndjekjes penale ndaj tij. Dosjet, të dhënat dhe prova të tjera që lidhen me veprën penale do t'i dërgohen Palës kërkuese. Pala kërkuese do të njoftohet për rezultatin e këtyre ndjekjeve.

Neni 36

1. Kërkesa për ekstradim që synon ushtrimin e ndjekjes penale duhet të shoqërohet me një kopje, e vërtetuar në përputhje me origjinalin, të vendimit që shpall ndalimin e përkohshëm, përshkrimin e fakteve që përbëjnë veprën penale dhe tekstin e dispozitës ligjore që jep cilësimin e veprës penale. Në qoftë se vepra penale ka shkaktuar një dëm material, atëherë, brenda mundësive, duhet të përcaktohet shuma në para e dëmit.

2. Kërkesa për ekstradim me qëllim ekzekutimi të një vendimi duhet të shoqërohet me një kopje, e vërtetuar në përputhje me origjinalin, të vendimit të formës së prerë si dhe me tekstin e plotë të dispozitës ligjore që jep cilësimin e veprës penale. Në këtë kërkesë duhet të saktësohet në rast se i dënuari ka vuajtur një pjesë të dënimit.

3. Kërkesa për ekstradim duhet të përmbajë të dhëna mbi kombësinë e personit që kërkohet për t'u ekstraduar dhe, brenda mundësive, shenja të veçanta

të tij, të dhëna për identitetin dhe vendbanimin e tij, dhe, kjo kërkesë duhet të shoqërohet me fotografinë dhe shenjat e gishtërinjve të tij.

4. Pala kontraktuese që kërkon ekstradimin nuk është e detyruar t'i bashkëngjisë kërkesës provat që lidhen me veprën penale të kryer nga personi që kërkohet për t'u ekstraduar.

Neni 37

Në rast se kërkesa për ekstradim nuk përmban të dhënat e nevojshme, Pala e kërkuar ka të drejtë të kërkojë që ajo të plotësohet. Për këtë qëllim, ajo mund të caktojë një afat, i cili nuk duhet t'i kapërcejë dy muaj, por që mund të zgjatet për shkaqe të justifikuara.

Neni 38

Pala e kërkuar, me të marrë kërkesën për ekstradim, ndërmerr sa më shpejt masat e domosdoshme për të arrestuar personin e përmendur në kërkesë. Kjo nuk ka të bëjë me rastet kur ekstradimi nuk mund të bëhet sipas dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 39

1. Personi i kërkuar për ekstradim mund të arrestohet provizorisht para se të merret kërkesa për ekstradim në rast se kjo kërkohet nga Pala kërkuuese, e cila afirmon njëkohësisht se ndaj këtij personi është marrë vendimi për arrestim të përkohshëm, vendimi i formës së prerë ose një vendim tjetër gjyqësor. Kërkesa për arrestim të përkohshëm mund të dërgohet me postë, telegrafisht ose me çdo mjet tjetër që le gjurmë të shkruar.

2. Në rast urgjence, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, përjashtimisht, mund të arrestojnë përkohësisht një person që gjendet në territorin e tyre, qoftë edhe pa kërkesën e parashikuar në paragrafin 1, në rast se ato janë në dijeni se ky person ka kryer, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, një vepër penale që përlligj ekstradimin.

3. Pala tjetër Kontraktuese duhet të njoftohet menjëherë për datën e arrestimit të përkohshëm të parashikuar në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 40

1. Personi i arrestuar përkohësisht sipas nenit 39 të kësaj Konvente mund të lirohet në rast se kërkesa për ekstradim ose kërkesa për t'a plotësuar atë nuk mer

kërkuese, ky afat mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera.

2. Pala Kontraktuese e kërkuar do të lirojë menjëherë personin e arrestuar përkohësisht në rast se merr njoftim se Pala kërkuese ka hequr dorë nga kërkesa për ekstradim.

Neni 41

1. Pala e kërkuar, pasi ka vendosur mbi kërkesën për ekstradim, mund t'a shtyjë dorëzimin e individit të kërkuar me qëllim që t'a ndjekë atë penalisht për shkak të një veprë penale të ndryshme nga ajo për të cilën kërkohet ekstradimi, ose me qëllim që ky të vuaj dënimin e dhënë në territorin e saj.

2. Në vend që të shtyjë dorëzimin, Pala e kërkuar mund t'i dorëzojë përkohësisht Palës kërkuese individin e kërkuar. Personi i ekstraduar përkohësisht duhet të rikthehet menjëherë pas kryerjes së akteve procedurale, për shkak të të cilave ai është ekstraduar dhe kjo brenda një afati që nuk duhet t'i kapërcejë katër muaj duke filluar nga data e ekstradimit të përkohshëm.

Neni 42

Në rast se disa shtete kërkojnë ekstradimin e të njëjtit person, atëherë i përket Palës së kërkuar të vendosë se cilit shtet do t'ia plotësojë kërkesën.

Neni 43

1. Pa dhënien e pëlqimit të Palës së kërkuar, personi i ekstraduar nuk mund të bëhet objekt i një ndjekjeje penale dhe as të vuaj një dënim për një veprë penale të kryer para ekstradimit dhe të ndryshme nga ajo që ka justifikuar kërkesën për ekstradim dhe as nuk mund t'i dorëzohet një Shteti të tretë për vepra penale të kryera përpara dorëzimit të tij.

2. Nuk kërkohet pëlqimi kur:

- a) personi i ekstraduar nuk është larguar nga territori i Palës Kontraktuese ku ai është ekstraduar brenda afatit prej një muaji duke filluar nga përfundimi i veprimeve procedurale ose, në rast se ai është dënuar, duke filluar nga data e ekzekutimit të dënimit. Ky afat nuk përfshin kohën gjatë së cilës personi i ekstraduar nuk ka mundur të largohet nga territori i Palës Kontraktuese për arsye të pavarura nga vullneti i tij.
- b) personi i ekstraduar, pasi është larguar nga territori i Palës Kontraktuese, rikthehet aty me dëshirën e vet.

Neni 44

1. Pala e kërkuar njofton Palën kërkuese mbi vendimin e saj për ekstradim.
2. Pala kërkuese njoftohet për arsyet e vendimit në rast se kërkesa e saj nuk është pranuar tërësisht ose pjesërisht.
3. Në rast pranimi të ekstradimit, Pala e kërkuar njofton Palën kërkuese për vendin dhe datën e ekstradimit. Në qoftë se Pala kërkuese, brenda afatit prej një muaji duke filluar nga data e caktuar për ekstradimin, nuk merr në dorëzim personin për të cilin është vendosur ekstradimi, atëherë ky duhet të lirohet.

Neni 45

Kur personi i ekstraduar i fshihet drejtësisë dhe rikthehet në territorin e Palës së kërkuar dhe Pala kërkuese bën një kërkesë të re për ekstradim, atëherë përcjellja e dokumenteve të përmendura në nenin 36 të kësaj Konvente nuk është e detyrueshme.

Neni 46

1. Secila nga Palët Kontraktuese, me kërkesë të Palës tjetër, autorizon kalimin tranzit nëpërmjet territorit të vet të personave që i ekstradohen kësaj nga një shtet tjetër. Palët Kontraktuese nuk janë të detyruara të autorizojnë kalimin tranzit kur, sipas dispozitave të kësaj Konvente, nuk rrjedh detyrimi për ekstradim.
2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese bien në ujdi mbi mënyrat, itinerarin dhe kushtet e tjera të kalimit tranzit.

Neni 47

Palët Kontraktuese do të njoftojnë njera tjetrën për rezultatet e ndjekjes penale të ndërmarrë ndaj personave të ekstraduar. Sipas kërkesës së bërë, ato i komunikojnë njera tjetrës edhe një kopje të vendimit të formës së prerë.

Neni 48

Për procedurën e ekstradimit dhe atë të arrestimit të përkohshëm zbatohet vetëm ligji i Palës së kërkuar.

Neni 49

Dokumentet që duhet të paraqiten për të mbështetur kërkesën për ekstradim duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën e Palës së kërkuar, në gjuhën frënge ose angleze, të vërtetuar sipas origjinalit.

*KREU VIII***TRANSFERIMI I PERSONAVE TE DENUAR PER TE VUAJTUR
DENIMIN NE SHTETIN KU JANE QYTETARE****Neni 50**

1. Qytetarët e njerës nga Palët Kontraktuese, të dënuar me vendim të formës së prerë me heqje të lirisë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do t'i transferohen, me marrëveshje të përbashkët dhe në kushtet e parashikuara nga kjo Konventë, Palës Kontraktuese ku ata janë qytetarë, për t'iu nënshtruar vuajtjes së dënimit në territorin e kësaj Pale.

2. Transferimi i të dënuarit për qëllim të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të Palës Kontraktuese, gjykata e së cilës ka shpallur dënimin (Shteti i dënimit), kur Pala tjetër Kontraktuese (Shteti i ekzekutimit) pranon t'a marrë atë në dorëzim.

3. Pala Kontraktuese ku i dënuari është shtetas, mund t'i bëjë kërkesë me shkrim Palës tjetër Kontraktuese, gjykata e së cilës ka shpallur vendimin, që kjo të shqyrtojë mundësinë e transferimit të të dënuarit.

Neni 51

I dënuari, përfaqësuesi i tij ligjor ose pjesëtarët e familjes së tij mund t'u drejtohen me shkrim autoriteteve kompetente të njerës prej Palëve Kontraktuese për të filluar procedurën e parashikuar në nenin 50. Autoritetet kompetente të Shtetit të dënimit njoftojnë të dënuarin mbi mundësinë e paraqitjes së një kërkesë të tillë.

Neni 52

Transferimi i të dënuarit bëhet vetëm kur vepra penale, për të cilën ai është dënuar, përbën gjithashtu një vepër penale sipas legjislacionit penal të Shtetit të ekzekutimit.

Neni 53

1. Transferimi i të dënuarit në Shtetin e ekzekutimit bëhet vetëm me pëlqimin e tij.

2. Kur i dënuari është i paafte të shprehë në mënyrë të vlefshme pëlqimin e tij, atëherë duhet të merret pëlqimi i përfaqësuesit ligjor të tij.

Neni 54

Shteti i ekzekutimit ve në dijeni, brenda afatit më të shkurtër, Shtetin e dënimit për pranimin ose mospranimin e transferimit të të dënuarit.

Neni 55

1. Kur Palët Kontraktuese kanë rënë dakord për transferimin, autoriteti kompetent i Shtetit të ekzekutimit detyrohet të respektojë natyrën dhe kohëzgjatjen e dënimit ashtu siç rezultojnë ato në vendimin e dënimit.

2. Kur natyra ose kohëzgjatja e këtij sanksioni janë të papajtueshme me legjislacionin e Shtetit të ekzekutimit ose kur legjislacioni i këtij Shteti e kërkon, autoriteti kompetent i Shtetit të ekzekutimit mund t'a përshtasë këtë sanksion me dënimin që parashikon ligji i brendshëm i tij për vepra penale të së njejtës natyrë. Ky dënim, sa i takon natyrës së tij, përputhet, me sa të jetë e mundur, me dënimin e dhënë nga vendimi gjyqësor. Ai nuk mund t'a bëjë më të rëndë, për nga natyra ose kohëzgjatja, sanksionin e dhënë në Shtetin e dënimit dhe as të tejkalojë afatin maksimal të parashikuar nga ligji i Shtetit të ekzekutimit për një vepër penale të të njejtit lloj.

3. Autoriteti kompetent i Shtetit të ekzekutimit duhet t'i përmbahet konstatimit të fakteve dhe nuk mund të zëvendësojë një vendim me heqje lirie me një sanksion të një lloji tjetër.

Neni 56

Në rastin kur Shteti i ekzekutimit ka dhënë pëlqimin, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, në afatin sa më të shkurtër, caktojnë vendin, datën dhe mënyrat e transferimit të të dënuarit. Transferimi i të dënuarit bëhet në territorin e Shtetit të dënimit.

Neni 57

1. Ekzekutimi i dënimit, duke përfshirë edhe dënimin me kusht, përcaktohet nga legjislacioni i Shtetit të ekzekutimit.

2. Amnistia zbatohet sipas legjislacionit të Shtetit të dënimit ose të Shtetit të ekzekutimit.

3. Falja zbatohet sipas legjislacionit të Shtetit të ekzekutimit.

4. Gjykata e Shtetit të dënimit është i vetmi juridiksion kompetent që vendos për çdo rekurs rishikimi që formulohet kundër vendimit të dënimit të dhënë ndaj të dënuarit të transferuar në Shtetin e ekzekutimit.

Neni 58

1. Palët Kontraktuese informojnë njera tjetrën për të gjitha rrethanat që mund të ndikojnë në ekzekutimin dhe, në mënyrë të veçantë, për amnistinë, për faljen ose për rrjedhojat që lindin nga rekursi i rishikimit të vendimit.

2. Shteti i ekzekutimit informon Shtetin e dënimit për përfundimin e vuajtjes së dënimit.

Neni 59

Dorëzimi i të dënuarit Shtetit të ekzekutimit kryhet, brenda mundësive, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 46.

Neni 60

1. Kërkesa e transferimit të të dënuarit përpilohet me shkrim.

2. Kërkesa shoqërohet:

- a) me një kopje të vërtetuar të vendimit, e pajisur me vërtetimin se vendimi ka marrë formë të prerë;
- b) me tekstin e dispozitave ligjore të zbatuara;
- c) me të dhëna sa më të sakta që të jetë e mundur të identitetit të të dënuarit, të kombësisë, vendbanimit dhe vendqëndrimit të tij të zakonshëm;
- d) me dokumente që përcaktojnë pjesën e vuajtur të dënimit nga i dënuari në Shtetin e dënimit;
- e) me një proces-verbal, përmbajtja e të cilit shpreh pëlqimin e të dënuarit;
- f) me çdo dokument tjetër që mund të ketë rëndësi gjatë shqyrtimit të kërkesës.

Neni 61

Kur Shteti i ekzekutimit çmon se të dhënat dhe dokumentet që i janë paraqitur atij janë të pamjaftueshme, ai mund të kërkojë plotësimin e informacionit të nevojshëm dhe të caktojë një afat për përcjelljen e dokumenteve shtesë, i cili mund të zgjatet në bazë të një kërkesë të justifikuar. Në mungesë të plotësimit të informacionit shtesë, Shteti i ekzekutimit vendos mbi bazën e të dhënave dhe dokumenteve që i janë vënë në dispozicion.

Neni 62

Kërkesat për transferim si dhe dokumentet që i shoqërohen atyre nuk kanë

nevojë për legalizim, por ato shoqërohen me përkthim në gjuhën e Shtetit të ekzekutimit, në frëngjisht ose në anglisht.

Neni 63

Shpenzimet e kryera për transferimin e të dënuarit janë në ngarkim të Shtetit të ekzekutimit, me përjashtim të shpenzimeve të kryera përjashtimisht në Shtetin e dënimit.

KREU IX

DISPOZITA TE NDRYSHME NE FUSHEN PENALE

Neni 64

Palët Kontraktuese marrin përsipër që, në përputhje me legjislacionet e tyre dhe me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese, të ndjekin penalisht shtetasit e tyre që kanë kryer një vepër penale në territorin e Palës tjetër.

Neni 65

1. Për të filluar ndjekjen penale të parashikuar nga neni 64, Palët Kontraktuese i komunikojnë njera tjetrës kërkesa të formuluar me shkrim, të cilat duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) emërtimin e autoritetit kërkuar;
- b) të dhëna për veprën penale që synon kërkesa, duke përfshirë këtu edhe përshkrimin për kohën dhe vendin e kryerjes së saj;
- c) të dhëna për personin e dyshuar, kombësinë e tij dhe, brenda mundësive, vendbanimin ose vendqëndrimin e tij;

2. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten:

- a) aktet procedurale përgatitore ose kopjet e tyre të vërtetuara konform origjinalit, të përpiluara në gjuhën e Palës kërkuese;
- b) dokumentet dhe të gjitha objektet që mund të shërbejnë si prova për bindje në çështjen penale; në këtë fushë zbatohen dispozitat e nenit 67 të kësaj Konvente;
- c) teksti i dispozitave të ligjit penal që zbatohet për veprën penale të kryer, e cila përshkruhet sipas ligjeve në fuqi në vendet e kryerjes së veprës penale;
- d) kur është e nevojshme dhe e mundshme, fotografia dhe shenjat e gishtrinjve të personit të dyshuar.

3. Pala Kontraktuese e thirrur nga kërkesa informon Palën tjetër për rezultatin e veprimeve procedurale dhe i komunikon asaj një kopje të vendimit të formës së prerë.

Neni 66

1. Kur del e nevojshme që personat e burgosur në territorin e Palës tjetër, të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarëve, Pala e kërkuar mund të japë pëlqimin për t'i dërguar këta persona në territorin e Palës kërkuese me kusht që ata të vazhdojnë të mbahen të burgosur dhe, pasi të jenë dëgjuar, të kthehen brenda një afati sa më të shkurtër që të jetë e mundur.

2. Kur del e nevojshme që persona të burgosur në territorin e një shteti të tretë, të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarëve, Palët Kontraktuese lejojnë kalimin tranzit të këtyre personave nëpërmjet territorit të tyre.

3. Dispozitat e nenit 28 të kësaj Konvente zbatohen, me sa të jetë e mundur, për paragrafet 1 dhe 2.

Neni 67

1. Objektet e ngjizura me vepren penale si dhe të gjitha objektet e tjera që mund të shërbejnë si prova për bindje në çështjen penale, i dorëzohen Palës kërkuese edhe në rast se ekstradimi nuk mund të kryhet për shkak të vdekjes së personit në fjalë ose për arsye të tjera.

2. Pala e kërkuar mund të shtyjë përkohësisht dorëzimin e objekteve në fjalë në rast se ajo i çmon të nevojshëm për një çështje tjetër penale.

3. Të drejtat e të tretëve mbi objektet që dorëzohen mbeten të paprekura. Pas përfundimit të veprimeve procedurale penale, këto objekte i jepen Palës që i ka dorëzuar me qëllim që kjo t'iu a rikthejë personave të interesuar.

Neni 68

Shpenzimet e kryera për ekstradimin dhe për dorëzimin e objekteve do t'i vihen në ngarkim Palës kërkuese, me përjashtim të shpenzimeve të bëra tërësisht në territorin e Palës së kërkuar.

Neni 69

1. Palët Kontraktuese i komunikojnë njera tjetrës, të paktën një herë në vit, informacionet për vendimet e dënimit të formës së prerë të dhëna ndaj shtetasve të Palës tjetër.

2. Palët Kontraktuese, sipas kërkesës së paraqitur, i komunikojnë njera

tjetrës të dhëna lidhur me precedentët gjyqësorë të personave që kanë qenë objekt dënimi në territorin e Palës së kërkuar dhe janë objekt i ndjekjes penale në territorin e Palës kërkuese.

3. Në rastet e parashikuara në paragrafet 1 dhe 2, Palët Kontraktuese, brenda mundësive, i komunikojnë njera tjetrës shenjat e gishtërinjve të personave të dënuar.

Neni 70

Dispozitat e kësaj Konvente mund të zbatohen edhe për kërkesat lidhur me fakte që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Konventës.

PJESA IV

KREU X

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 71

1. Kjo Konventë ratifikohet dhe hyn në fuqi tridhjetë ditë pas shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit.


2. Kjo Konventë nënshkruhet dhe vlen për një periudhë kohore të pacaktuar. Ajo mund të denoncohet nëpërmjet kanaleve diplomatike nga secila prej Palëve Kontraktuese. Në një rast të këtillë, ajo do të shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së denoncimit.

Në mirëbesim, të Plotfuqishmit e Palëve Kontraktuese nënshkruajnë dhe vulosin këtë Konventë.


Bërë në Tiranë me 15 mars 1995 në dy kopje, ku secila prej tyre e hartuar në tre gjuhët: shqip, turqisht dhe frëngjisht dhe secili nga këto tekste do të merret në mirëbesim. Në rast mosmarrëveshje, referimet do të bëhen vetëm nga teksti në frëngjisht.

Për Republikën e Shqipërisë

Hektor FRASHËRI
Ministër i Drejtësisë i
Republikës së Shqipërisë



Për Republikën e Turqisë



A. Metin ÖRNEKOL
Ambasador
i Republikës së Turqisë
në Shqipëri